



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2022

V E N D I M

Nr. 219, datë 13.12.2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.86, datë 31.05.2022, e znj. A.A., ku pretendohet diskriminim për shkak të *“bindjes politike”*, *“gjendjes arsimore”*, *“gjinisë”* dhe *“për çdo shkak tjetër”* nga ana e Bashkisë Shkodër.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas informacionit të dhënë në ankesë, rezulton se ankuesja ka punuar pranë Bashkisë Shkodër, prej muajit mars 2005, në pozicionin e specialistes së buxhetit. Në vitet në vijim, ajo ka punuar në pozicione të tjera pune dhe është rritur në detyrë dhe përgjegjësi. Znj. A.A. sqaron se gjashtë vitet e fundit ka punuar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, institucion ky në varësi të Bashkisë Shkodër.

Znj. A.A. thekson faktin se pas 16 vitesh pune pranë këtij institucioni, ku ka patur gjithnjë vlerësime të mira, është liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr. 228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, pa asnjë motivacion dhe duke mos u zbatuar asnjë procedurë ligjore e parashikuar në Kodin e Punës. Ankuesja pretendon se largimi i saj nga puna pa asnjë shkak të justifikueshëm dhe të ligjshëm, ka lidhje me preferencën e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për të liruar pozicionin e saj të punës, me qëllim punësimin e një eksponenti politik të afërt me titullarin e institucionit, z. E.I. Ajo thekson faktin se është larguar nga puna, pasi Kryetari i Bashkisë Shkodër ka patur preferencë të emërojë në vend të saj, një person me bindje politike

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

dhe klanore të kahut të tij. Znj. A.A. shprehet se ajo nuk është e angazhuar në asnjë forcë politike, por ka punuar si tekniciene dhe është vlerësuar pozitivisht nga kryetarët e tjerë të Bashkisë Shkodër.

Ankuesja sqaron se në të drejtën ndërkombëtare, shpesh përdoret termi “mendimi politik” dhe me këtë term përfshihet “përkatësia politike”, e cila interpretohet në mënyrë që të mbulojë lidhjen me ndonjë opSION të caktuar politik ose parti politike, me të cilën do të përfshihen rastet, kur bëhet fjalë për përkatësinë formale (anëtarësinë), por edhe llojet e tjera të lidhjeve, përmes së cilave mund të tregohet lidhja me ndonjë parti, ose opSION tjetër politik. Me qëllim interpretimi sa më gjithëpërfshirës të këtij shkak, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, rekomandohet që në shkakun e përkatësisë politike, të përfshihen rastet e anëtarësisë formale ose **jo formale** dhe llojet e tjera të lidhjes me partinë politike. Këtë qëndrim mban edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e cila në Vendimin nr. 31/2021, pika 67, shprehet se: “...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të patur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situatë faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin sikurse është arsyetuar në vendim, nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”. Pra, duke mos qenë pjesë e asnjë strukture apo partie politike, ankuesja pretendon se është diskriminuar pa të drejtë, duke u zëvendësuar nga një bashkëpunëtor i afërt politik i Kryetarit të Bashkisë Shkodër. Personi në fjalë, sipas ankueses, është kandidat nga Komisioni i Rithemelimit, për Kryetar të Partisë Demokratike Shkodër, fakte këto, të cilat janë të bëra publike në media dhe dihen botërisht.

Lidhur me shkakun e diskriminimit “gjendja arsimore”, ankuesja pretendon se personi nga i cili është zëvendësuar në pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit të Bashkisë Shkodër, nuk ka as përvojën dhe as kualifikimet e saj në punë në profilin ekonomik. Ankuesja pretendon se drejtuesi i ri i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ka arsim juridik dhe për një fakt të tillë, ai është favorizuar në krahasim me të. Për këtë arsye, ajo e konsideron si diskriminim të saj për shkak të gjendjes arsimore.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “bindjes politike”, “gjendjes arsimore” dhe “për çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërma c) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Hapat proceduriale të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr.86, datë 31.05.2022, e znj. A.A., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua z. B.S., Kryetar i Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 800/2 Prot., datë 08.06.2022, ku kërkohej informacion mbi çështjet e mëposhtëme:
1. Informacion mbi pretendimet e ankueses A.A.;
 2. Kopje e praktikës së lirimit të saj nga detyra;
 3. Informacion mbi motivacionin e largimit të ankueses nga detyra, provuar kjo me fakte dhe prova konkrete;
 4. Informacion mbi personin e emëruar në ish-pozicionin e punës së ankueses. Praktika e emërimit dhe kopje e dosjes së tij personale;
 5. Kopje e të gjithë akteve të emërimit në detyrë të ankueses;
 6. Kopje e përshkrimit të saj të punës për pozicionin “Drejtore të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit”, ku të jenë reflektuar kriteret arsimore të pozicionit të punës;
 7. Kopje e kontratës individuale të punës së ankueses me Bashkinë Shkodër;
 8. Informacion nëse ndaj ankueses janë marrë masa disiplinore gjatë periudhës kohore që ka punuar pranë Bashkisë Shkodër. Nëse po, të dërgohen praktikat respektive për dhënie mase disiplinore;
 9. Informacion mbi performancën në punë të ankueses. Të dërgohet të gjithë vlerësimet e saj të punës;
 10. Informacion nëse çështja e zgjidhjes së kontratës së saj të punës është duke u shqyrtuar gjyqësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nëse po, të jepet informacion nëse gjykata është shprehur me vendimmarrje;
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, z. B.S., Kryetar i Bashkisë Shkodër, dërgoi shkresën nr.9366/1 prot., datë 17.06.2022, nëpërmjet së cilës sqarohet se referuar ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, të ndryshuar, Bashkia Shkodër ka detyra

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

dhe përgjegjësi për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Në këtë kontekst, pranë Bashkisë Shkodër ushtron veprimtarinë e saj Drejtoria Ekonomike e Arsimit, si institucion varësie e Bashkisë Shkodër. Struktura administrative e kësaj drejtorie është pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Shkodër. Procedura e rekrutimit dhe mënyra e rregullimit të marrëdhënieve të punës, të punonjësve të administratës së institucioneve të varësisë bazohet në Kodin e Punës dhe në kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, të ndryshuar.

Në lidhje me pretendimet e ankueses, Bashkia Shkodër sqaron se ato nuk janë të provuara me fakte dhe prova konkrete. Sigurimi dhe plotësimi i detyrimeve dhe nevojave për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore të sistemit shkollor parauniversitar janë të karakterit material dhe burimeve njerëzore. Në të dy këto elementë janë evidentuar veprime dhe/ose mosveprime, të cilat kanë cënuar parimin e mirëbesimit për funksionimin e punës në Drejtorinë Ekonomike të Arsimit dhe është vlerësuar e domosdoshme rishikimi i organizimit të stafit të administratës së kësaj drejtorie në tërësi, nga drejtuesi deri në personelin e shërbimeve mbështetëse të kësaj strukture. Procedura e rishikimit të organizimit të staft të administratës së Drejtorisë Ekonomike dhe të Arsimit është e njohur edhe për ankuesen A.A., pasi nëpërmjet së njëjtës procedurë dhe për të njëjtat motive, ajo është rekrutuar në pozicionin e drejtorit të kësaj drejtorie.

Në lidhje me shqyrtimin gjyqësisht të çështjes së zgjidhjes së menjëherëshme të marrëdhënieve të punës (kontratës së punës) nga organet e drejtësisë, Bashkia Shkodër shprehet se nuk ka informacion.

Bashkëlidhur shkresës nr.9366/1 prot., datë 17.06.2022, Bashkia Shkodër ka depozituar pranë KMD-së, kopje të aktit administrativ të lirimit nga detyra të ankueses A.A. dhe kopje të dosjes së saj personale. Njëkohësisht ky institucion ka depozituar edhe kopje të aktit të emërimit dhe dosjes personale të personit që e ka zëvendësuar ankuesen, z. E.I.

1. Në vijim të procedurave hetimore, KMD vendosi realizimin e seancës dëgjimore në datën 06.09.2022, ora 11:00 dhe palët u njoftuan nëpërmjet shkresës nr. 800/6 Prot., datë 25.07.2022, së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesja A.A. dhe përfaqësuesi i saj ligjor, si dhe përfaqësuesi me autorizim të Bashkisë Shkodër. Ankuesja parashtroi edhe një herë pretendimet e saj për diskriminim për shkak të gjendjes politike, gjendjes arsimore dhe për çdo shkak tjetër. Fillimisht, përfaqësuesit e KMD-së kërkuan që znj. A.A. të sqaronte se cili është subjekti real (Kryetari i Bashkisë Shkodër në cilësinë e personit fizik brenda personit juridik apo Bashkia Shkodër, në cilësinë e personit juridik) kundër së cilit drejtohet ankesa. Ankuesja sqaroi se subjekti kundër së cilit drejtohej ankesa është Bashkia Shkodër. Ajo u shpreh se ka më tepër se 16 vjet që punon pranë Bashkisë Shkodër dhe ka mbajtur pozicione të ndryshme pune. Ankuesja sqaroi se ka punuar me 4 kryetarë bashkie. Në datën 27 prill 2022 i bëhet e ditur shkarkimi nga detyra pas asnjë motivacion dhe pa zbatuar asnjë procedurë

të lirit nga detyra, sikurse parashikohet në Kodin e Punës. Ajo sqaron se nga Kryetari i Bashkisë i është komunikuar se ai do të punojë me njerëzit e stafin e tij dhe se ajo nuk i shërbente në atë pozicion pune. Ankuesja sqaroi se drejtorja që ka drejtuar është një drejtori me një numër të madh punonjësish, rreth 227 të tillë dhe ka kryen funksione të rëndësishme. Ajo shprehet se zëvendësuesi i saj në ish pozicionin e punës, është një ish-koleg që ka punuar specialist në një drejtori tjetër të Bashkisë Shkodër, me një eksperiencë 7 vjeçare në punë, pa lidhje me pjesën e funksionit të drejtorisë ku është emëruar drejtor. Ky person është anëtar i Partisë Demokratike të Krahut të Themelimit dhe gjithashtu është drejtues i njërit prej grup seksioneve të kësaj partie në Shkodër. Ajo shprehet se bindjet e saj janë të djathta dhe se ka përkrahur kandidatin tjetër të Partisë Demokratike, fjalë të cilat duhet të kenë shkuar në veshin e kryetarit aktual të Bashkisë Shkodër. Pas lirit nga detyra, ankuesja shprehet se ka depozituar ankesë pranë Bashkisë Shkodër në datën 28 prill 2022, ku ka kërkuar informacion mbi arsyet e largimit nga puna, arsyet përse nuk janë ndjekur procedurat përkatëse si dhe ka kërkuar rikthim në punë. Ajo ka dërguar një tjetër shkresë tjetër pranë Bashkisë Shkodër ku ka kërkuar informacion, se cili ka qenë konceptuesi i shkresës së lirit nga detyra. Këtë shkresë e ka dërguar në korrik 2022, ndërkohë që një tjetër shkresë të tretë ia ka drejtuar Bashkisë Shkodër ku ka kërkuar dosja e saj personale. Bashkia Shkodër ka dërguar përgjigje vetëm për shkresën e tretë. Në vijim, kanë depozituar kërkesëpadi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ajo sqaroi se në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Arsimore ka filluar punë si drejtoreshë e komanduar në muajin prill të vitit 2016. Paraprakisht ka punuar në pozicionin e specialistes së marrëdhënieve me jashtë pranë Bashkisë Shkodër, pozicion, i cili u suprimua pas ardhjes në detyrë të kryetares së re të bashkisë. E pyetur mbi vlerësimet e punës, ajo u shpreh se nuk ka patur vlerësime pune nga Kryetari i Bashkisë Shkodër. Ndër të tjera, ajo u shpreh se ka qenë e vetmja drejtuese femër e institucioneve të varësisë së bashkisë Shkodër që është larguar nga puna. E pyetur mbi numrin dhe gjininë e drejtuesve të tjerë të institucioneve të varësisë të Bashkisë Shkodër, ankuesja u përgjigj se janë 6-7 të tillë, ndër të cilët 3 janë femra dhe pjesa tjetër meshkuj. Në këtë kontekst, ajo deklaroi se edhe gjinia është shkak i shtuar në ankesën e saj.

Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër sqaroi se Drejtorja Ekonomike Arsimore është një ndër institucionet e varësisë së Bashkisë Shkodër, e cila ka si kompetencë mirëmbajtjen e objekteve arsimore si nga ana infrastrukturore ashtu edhe për sa i përket burimeve njerëzore. Të gjithë drejtorët e institucioneve të varësisë së bashkisë Shkodër kanë varësi të drejtpërdrejtë nga Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe llogaridhënia e tyre kryhet vetëm para këtij titullari, i cili ka të drejtën e emërimit dhe shkarkimit të tyre. Për lirin e ankuese nga detyra, Kryetari i Bashkisë mund të ketë konstatuar veprime ose mosveprime të saj, që kanë cënuar parimin e mirëbesimit në marrëdhëniet e punës, por nuk ka indicie për diskriminim politik.

Lidhur me pretendimin e diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore, ai u shpreh se kriteri për emërim në pozicionin e drejtuesit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, është arsimi i lartë dhe në këtë pozicion mund të emërohet kushdo që ka një arsim të tillë. I pyetur nëse ka një kontratë pune të lidhur ndërmjet ankuses dhe Bashkisë Shkodër, ai u shpreh se nuk ka një të tillë, pasi për të gjithë drejtuesit e institucioneve të varësisë të Bashkisë Shkodër nuk janë hartuar dhe lidhur kontrata individuale pune

por thjesht janë emëruar me akt administrativ të Kryetarit të Bashkisë. I pyetur për vlerësimet në punë të drejtorëve të institucioneve të varësisë dhe metodat e vlerësimit të punës së tyre dhe specifikisht të ankueses, ai u shpreh se nuk ekziston asnjë detyrim ligjor dhe asnjë mekanizëm që merret me vlerësimin e tyre. Auditimet e kryera në këto institucione shërbejnë për vlerësimin e tyre. I pyetur mbi dhënien e vërejtjeve ndaj ankueses për auditime të kryera, ai u shpreh se për ankuesen janë gjetur mangësi nga audit i kryer në periudhën mars-prill 2022. Nga ky audit nuk ka vërejtje të drejtpërdrejta për ankuesen, por për drejtorinë që ajo drejtonte. I pyetur se ku është cënuar parimi i mirëbesimit nga ankuesja, ai u shpreh se nuk ka ndonjë fakt të argumentuar për cënimin e këtij parimi. Janë konstatuar parregullsi organizative në Drejtorinë Ekonomike të Arsimit, nga audit, të cilat do të përcillen në vijim zyrtarisht. I pyetur nëse ankuesja është njoftuar zyrtarisht mbi një çështje të tillë dhe ka paraqitur objeksionet e saj, ai u shpreh se nuk është kryer një gjë e tillë pasi largimi i saj nga puna ka qenë i menjëhershëm. Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër u shpreh se informacioni mbi këtë moment do të përcillet në vijim zyrtarisht. I pyetur mbi procedurën e ndjekur për largimin e ankueses nga puna, ai sqaroi se janë realizuar komunikime verbale të kryetarit të bashkisë me ankuesen, por nuk është dhënë një njoftim me shkrim. Largimi ka qenë i menjëherëshëm nga puna. I pyetur sërish mbi personin që e ka zëvendësuar ankuesen dhe pjesëmarrjen e tij në politike, përfaqësuesi i bashkisë Shkodër u shpreh se drejtori aktual i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ka qenë nëpunës civil pranë Bashkisë Shkodër dhe si i tillë e ka patur të ndaluar ligjërisht të bëjë pjesë në organet drejtuese të partive politike. Në këto kushte, nuk ka patur indicie për të hetuar dhe verifikuar nëse ky person ka patur pjesëmarrje në parti politike. Ky person ka dhënë dorëheqje nga pozicioni i mëparshëm i punës dhe ka depozituar kërkesë për t'u emëruar në pozicionin aktual. I pyetur në lidhje me procedurën e ndjekur për shpalljen e vendit të punës drejtor i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër sqaroi se për këtë pozicion pune nuk është kryer shpallje e vakancës, por Kryetari i Bashkisë ka vlerësuar emërimin e personit të sipërcituar në këtë pozicion pune. Ai sqaroi gjithashtu se Kodi i Punës nuk e detyron punëdhënësin për të shpallur vendin e punës, por në disa raste Bashkia Shkodër vepron me shpallje për të patur sa më shumë kandidatura për pozicionin e punës.

Ai u shpreh se Bashkia Shkodër ka 7 (shtatë) institucione varësie dhe 2 (dy) institucione me varësi të dyfishtë, të Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. I pyetur nëse ka drejtues të tjerë të institucioneve të varësisë të larguar nga puna, ai u shpreh se përveç ankueses nuk ka drejtues të tjerë të larguar nga puna.

Ankuesja u shpreh se raporti paraprak i auditit daton në muajin qershor 2022 për të cilin ajo ka bërë observacionet e saj dhe ia ka drejtuar drejtorisë përkatëse dhe institucionit përgjegjës. Ndërkohë që nuk i është dërguar asnjë Raport Përfundimtar, që ajo ta nënshkruajë ose jo për dakordësi.

Znj. A.A. sqaron se personi që aktualisht mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ka qenë kandidatë në zgjedhjet primare të PD-së për kryetar bashkie dhe ka dalë me një deklaratë publike, ku tërhiqet nga garimi për këtë pozicion, pasi mbështet kandidaturën e kryetarit aktual të Bashkisë Shkodër.

Përfaqësuesi ligjor i ankueses vuri në dukje faktin se cënimi i parimit të mirëbesimit sipas nenit 153 të Kodit të Punës, konsiston në shkelje të rënda të punonjësit ose shkelje të lehta të përsëritura nga ana e tij, për të cilat ai njoftohet me shkrim. Në këtë kontekst, ai thekson se ankuesja në asnjë rast nuk është vënë në dijeni me shkresë zyrtare mbi shkeljet e konstatuara.

Përfaqësuesit të Bashkisë Shkodër iu kërkua të përcillte në vijim pranë KMD-së, rregulloren e brendshme të bashkisë Shkodër, përshkrimet e punës, datën e emërimit në detyrë dhe gjininë e drejtorëve aktualë të institucioneve të varësisë.

Përfaqësuesi i ankueses sqaroi se një shkak tjetër për largimin nga puna të ankueses, është dhe fakti se znj. A.A. ka mbajtur ditët e punës për disa punonjës të drejtorisë që drejtonte, pasi ata kanë rezultuar me shkelje. Këta punonjës janë anëtarë të partisë politike, ku aderohet Kryetari i Bashkisë Shkodër. Lidhur me këtë shkak, përfaqësuesit e KMD-së kërkuan prova dhe fakte të reja, që të shërbenin si indicie për KMD-në dhe të shtrinte hetimin e tij edhe mbi të. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e KMD-së i kërkuan ankueses informacion mbi emrat e këtyre punonjësve dhe anëtarësinë e tyre në parti politike, shkeljet që kanë kryer të mbështetura në prova dhe fakte konkrete, listëprezencat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, për ato muaj kur këta persona rezultojnë me pagesa të mbajtura për disa ditë pune, si dhe çdo informacion tjetër që ankuesja e vlerësonte të nevojshëm për të vërtetuar dhe mbështetur pretendimin e saj, të ngritur në seancë dëgjimore. Njëkohësisht, përfaqësuesit e KMD-së ranë dakord me ankuesen dhe përfaqësuesin e bashkisë Shkodër, që çdo shkresë që do t'i drejtohej Komisionerit në vijim të kësaj seancë, t'i drejtohej gjithashtu për dijeni edhe palës tjetër, në mënyrë që pala respektive të dërgonte informacionin kundërshtues, nëse do të kishte të tillë, brenda një periudhe të shkurtër kohore.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD iu drejtua Bashkisë Shkodër dhe për dijeni ankueses A.A., me shkresën nr. 1214/1, datë 08.09.2022, nëpërmjet së cilës kërkoi informacionin e mëposhtëm:
 1. Informacion mbi pretendimet e ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë, shkak ky, i cili u shtua nga ana e saj gjatë seancës dëgjimore;
 2. Informacion mbi gjininë dhe datën e emërimit në detyrë të të gjithë drejtorëve të institucioneve të varësisë së Bashkisë Shkodër;
 3. Informacion mbi numrin e drejtorëve të institucioneve të varësisë së Bashkisë Shkodër, që janë liruar nga detyra me urdhër të kryetarit aktual të këtij institucioni;
 4. Kopje e Rregullores së Brendshme të Bashkisë Shkodër;
 5. Kopje e përshkrimit të punës për pozicionin “Drejtore të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit”, ku të jenë reflektuar kriteret arsimore të pozicionit të punës, si dhe përshkrimet e punës së drejtorëve të institucioneve të tjera të varësisë së Bashkisë Shkodër;
 6. Kopje të Raportit Përfundimtar (2022) të Auditit të Brendshëm të Bashkisë Shkodër mbi veprimtarinë e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, në varësi të këtij institucioni;

7. Mbështetur në Raportin e sipërcituar të evidentohen shkeljet e ankueses, të cilat Bashkia Shkodër i konsideron si cënim të parimit të mirëbesimit në marrëdhëniet e punës nga ana e znj. A.A..
 8. Procedurat e ndërmarra nga Bashkia Shkodër, në përputhje me nenin 153 të Kodit të Punës, për vënien në dijeni me shkrim ankuesen me shkeljet respektive, të evidentuara në Raportin e Auditit;
 9. Observacionet e paraqitura nga znj. A.A. në lidhje me këto shkelje;
 10. Kopje të shkresave të znj. A.A. të dërguara pranë Bashkisë Shkodër në vijim të lirimit të saj nga detyra, si dhe përgjigjet zyrtare të Bashkisë Shkodër të dërguara në adresë të ankueses;
- Në vijim të shkresës së sipërcituar të KMD-së, ankuesja A.A. dërgoi në adresë të Komisionerit shkresën nr. 800/7, datë 13.09.2022, ku kërkon shpjegime nga Komisioneri se përse në shkresën e sipërcituar, nuk i është kërkuar Bashkisë Shkodër informacion lidhur me pretendimin e saj të shtuar në seancë dëgjimore, për diskriminim pasi nuk i ka paguar disa ditë punë punonjësit O.V., i cili është anëtar i subjektit politik, ku aderohet edhe kryetari i Bashkisë Shkodër. Ajo shprehet se kryetari i Bashkisë Shkodër i ka dhënë urdhëra verbalë për ta paguar punonjësin O.V., urdhëra të cilat ajo nuk i ka zbatuar. Për këtë arsye, ajo mendon se ky përbën shkak për diskriminimin e saj.
 - Pas administrimit të shkresës së sipërcituar, strukturat përgjegjëse të KMD-së kontaktuan me telefon me ankuesen dhe i kujtuan se sikurse ishte rënë dakord në seancë dëgjimore, këtë pretendim të shtuar, ajo duhet ta mbështeste me fakte dhe prova konkrete, të cilat duhet t'ia bënte të ditur edhe Bashkisë Shkodër, e cila në vijim do të jepte kundërshtimet e saj. Njëkohësisht, znj. A.A. iu vu në dukje fakti se bashkëlidhur shkresës së saj nuk kishte asnjë provë, nga ato që ishin cituar gjatë seancës, që ajo të mbështeste pretendimin e saj të shtuar dhe të shërbente si indicie për KMD-në, për të hetuar mbi këtë rast. Ankuesja ra dakord për sa më sipër.
 - Në vijim të shkresës së KMD-së, Bashkia Shkodër dërgoi pranë KMD-së dhe për dijeni të ankueses A.A., shkresën nr.13598 prot., datë 15.09.2022, nëpërmjet së cilës informon se në lidhje me pretendimet e znj. A.A. ku pretendohet diskriminim për shkak të bindjes politike, gjendjes arsimore, gjinisë si dhe për çdo shkak tjetër, ritheksohet se pretendimet e saj nuk janë pretendime të provuara me fakte dhe prova konkrete, por janë të referuara vetëm si opinione personale. Referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ndër të drejtat, përgjegjësitë dhe funksionet, kompetencat si dhe funksionet e deleguara njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë veprimtarinë e tyre 6 institucione varësie, drejtuesit/titullarët e të cilave emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Bashkisë në përputhje të plotë me kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, të njohura në nenin 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Në vijim, Bashkia Shkodër paraqet në formë tabelore, institucionet e varësisë, drejtuesit e saj aktualë, datën e emërimit në detyrë, gjininë dhe arsimin përkatës. Në shkresë theksohet fakti se me vendim të kryetarit aktual të Bashkisë Shkodër është liruar nga detyra znj. A.A., me detyrë drejtor, Drejtoria Ekonomike e Arsimit.

Për sa i përket përshkrimit të punës dhe kriterëve arsimore për pozicionin e punës të drejtuesve/titullarëve të institucioneve të varësisë në tërësi, duke përfshirë edhe Drejtorinë Ekonomike të Arsimit, megjithëse nuk janë të vecuar në kontrata konkrete, duke qenë pozicione drejtuese dhe menaxheriale ato janë të evidentuara në legjislacionin përkatës për secilën drejtori. Në shkresë theksohet fakti se drejtuesit/titullarët e këtyre institucioneve janë edhe nëpunës autorizues për institucionet që drejtojnë dhe veprimtaria e tyre është e lidhur me ligjin për menaxhimin dhe kontrollin financiar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Bashkëlidhur shkresës është dërguar një kopje e raportit përfundimtar (2022) të Auditit të Brendshëm të Bashkisë Shkodër mbi veprimtarinë e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit. Referuar Raportit në fjalë janë evidentuar shkelje që konsiderohen cënim i parimit të mirëbesimit në marrëdhëniet e punës nga ana e znj. A.A., si vijojnë:

1. **Zbatimi i rekomandimeve** – Moszbatimi i rekomandimeve të lëna në raport auditimin nr. 1086/b, datë 11.04.2018, nga ky rezulton se nga 17 rekomandime vetëm 6 të tillë janë realizuar, ndërsa 3 rekomandime janë realizuar pjesërisht dhe 8 rekomandime nuk janë realizuar.
2. **Sistemi i kontrollit të brendshëm** – Neglizhencë e theksuar në realizimin e detyrave funksionale;
3. **Sistemi i menaxhimit të buxhetit** – Nuk janë respektuar procedurat e monitorimit të buxhetit. Këto veprime kanë sjellë administrim të buxhetit të padokumentuar dhe pa evidentuar në mënyrë të qartë rezultatet dhe përfituesit.
4. **Transaksionet e kryera nëpërmjet bankës** – mospërbushje e detyrave funksionale të nëpunësit autorizues e zbatues.
5. **Mjetet në dispozicion në përmbushjen e objektivave** – nuk janë përmbushur detyrat funksionale sipas strukturës dhe nuk është hartuar plani i kontrollit të brendshëm.
6. **Të tjera gjetje gjatë auditimit, magazina ushqimore dhe përdorimi i lëndës djegëse për mjetet e transportit:**
 - mospërbushje e detyrave funksionale të nëpunësit autorizues dhe zbatues, komisioni i marrjes në dorëzim dhe përgjegjësit materialë dhe komisioni i inventarizimit;
 - Mospërbushje e detyrave funksionale nëpunësit autorizues që nuk ka ushtruar kontroll mbi procedurat e ndjekura për furnizimin me karburant dhe që ka autorizuar punonjësit për furnizimin me karburant të majinave personale;

Nisur nga shkeljet e sipërcituara është bërë njoftimi verbal ankueses A.A. për zgjidhjen e menjëherëshme të marrëdhënieve të punës në përputhje me nenin 153 të Kodit të Punës.

Bashkëlidhur shkresës janë dërguar kopje të observacionit nr. 10 892, datë 05.07.2022, të paraqitur nga znj. A.A. në lidhje me shkeljet e lartpërmendura, si dhe përgjigjet zyrtare të Bashkisë Shkodër të dëguara në adresë të ankueses.

- Në vijim të shkresës së Bashkisë Shkodër, ankuesja A.A. dërgoi në adresë të KMD-së dhe për dijeni të Bashkisë Shkodër, shkresën nr. 800/9, datë 29.09.2022, ku sqaron se ka filluar marrëdhëniet e punës në bashkinë Shkodër në mars të vitit 2005 si specialiste buxheti dhe ndër vite është ngritur në detyrë duke mbajtur pozicione të tilla pune si përgjegjëse e sektorit të buxhetit, specialiste e sektorit të marrëdhënieve me jashtë, pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, specialiste pranë drejtorisë së Koordinimit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë, specialiste pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

Gjatë viteve të fundit, ajo sqaron se ka ushtruar funksionin e Drejtores së Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, institucion varësie pranë Bashkisë Shkodër, ku gjatë ushtrimit të detyrave ka vepruar me korrektësi, duke zbatuar të gjitha detyrat që kishte pozicioni i punës. Pas 17 vitesh pune, me një performancë të mirë ajo është liruar nga detyra në datën 27.04.2022, brenda ditës dhe pa zbatuar asnjë procedurë ligjore dhe administrative (njoftim paraprak), pa asnjë motivacion apo shkaqe të justifikueshme, por thjesht për preferencë të Kryetarit të ri të Bashkisë Shkodër për t'i liruar vendin e punës një eksponenti politik, z. E. I., i cili është anëtar partie, kryetar i grupit të seksionit të grupit të rithemelimit të PD-së), i cili është shpërblyer nga Kryetari i Bashkisë për angazhimin e tij për të mbështetur z. B.S. në fushatën zgjedhore. Në këtë kontekst, z. B.S. nëpërmjet këtij veprimi ka kryer diskriminim duke e larguar nga puna dhe duke emëruar në vendin e saj dike tjetër bazuar në preferencën dhe parapëlqimit politik. Gjithashtu, sqaron ankuesja, z. E.I. ka qenë kandidatë për kryetar bashkie në listën e primareve të muajit shkurt 2022 dhe është dorëhequr për të mbështetur z. B.S., në fushatën zgjedhore, sipas një statusi në faqen e tij në Facebook ka mbështetur publikisht kandidaturën e B. S., status i cili është publikuar nga disa rrjete sociale dhe portale. Gjatë shpjegimeve të dhëna për rastin e diskriminimit politik, përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër u shpreh se Bashkia Shkodër nuk kishte dijeni që z. E.I. është person me aktivitet politik dhe se është e ndaluar që një punonjës i shërbimit civil të jetë pjesë e një partie politike. Ankuesja sqaron se z. E.I. ka patur aktivitet politik që gjatë kohës kur ka qenë nëpunës i shërbimit civil, sikurse edhe aktualisht. Në rastin konkret, ajo shprehet se është larguar nga puna thjesht se Kryetari i Bashkisë ka patur preferencë dhe ka parapëlqyer të emërojë në vendin e saj të punës një person me bindje politike dhe klanore në krah të tij dhe të largojë znj. A.A. nga puna, duke iu shprehur verbalisht se ajo ka shprehur pikëpamjet e saj për kandidatin Xh.B., si dhe kryetari do që të punojë me njerëzit e tij.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar, pasi nuk është pjesë e strukturave të asnjë partie politike, duke u larguar nga puna dhe duke u zëvendësuar më një bashkëpunëtor të afërt politik të Kryetarit të Bashkisë Shkodër. Ky fakt, shprehet znj. A.A., është i njohur publikisht në media dhe dihet botërisht.

Ajo shprehet se përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër aludoi në seancë dëgjimore se vendimi i Kryetarit të Bashkisë është marrë në bazë të rezultateve të një auditi të brendshëm, por nuk specifikoi se cilat ishin shkeljet konkrete të kryera nga ana e saj. Ankuesja sqaron se është liruar nga detyra në datën

27.04.2022 dhe raporti paraprak i auditit mban datën 23.06.2022. Kjo tregon se, ajo është paragjykuar që në fillim dhe nëse ka ndonjë pretendim nga auditit për shkelje, kjo tregon se këto pretendime janë ngritur me qëllim pasi Bashkia Shkodër ka marrë dijeni që ndaj saj është bërë ankim pranë KMD-së. Ankuesja shprehet se ka observuar, mbështetur në prova, projekt-raportin e auditit. Deri më sot, asaj nuk i është komunikuar raporti përfundimtar. Projekt raporti i auditit nuk ka vlerë ligjore, pasi është nxjerrë pas lirimit të saj nga detyra.

Lidhur me diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore, ankuesja sqaron se është larguar nga detyra pa asnjë motivacion dhe lirimi nga detyra nuk bazohet në fakte dhe prova. Në vendin e saj është emëruar një individ që nuk ka përvojën e saj të punës dhe as kualifikimin për atë pozicion pune, me profil ekonomik, pasi vetë funksioni i drejtorisë ka të bëjë me menaxhimin e aseteve publike (objekteve shkollore), përgatitjen e buxhetit, llogaritjen e shpenzimeve dhe kostove për çdo aktivitet shpenzimi. Në këtë kontekst, ajo pretendon diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, pasi është favorizuar një individ që ka arsim të profilit jo ekonomik, pa eksperiencë pune në menaxhimin e financave publike, pasi eksperiencia e vetme e punës së personit të emëruar në ish-pozicionin e saj të punës ka qenë specialist në qendrat komunitare dhe pranë sektorit të strehimit, në profil social. Ankuesja shprehet se gjatë gjithë karrierës së saj ajo ka dhënë rezultate pozitive në punë dhe me këtë veprim të kryetarit të bashkisë ajo është viktimizuar duke i cënuar dinjitetin njerëzor.

A.A. shprehet se përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër është shprehur në seancë dëgjimore se personi që ka zëvendësuar ankuesen ka dhënë dorëheqjen nga shërbimi civil disa ditë më parë dhe është emëruar si Drejtues i Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, në datën 27.04.2022. Kërkesa e tij për dorëheqje është paraqitur pranë kryetarit në datën 27.04.2022 dhe po në atë datë është marrë vendimi i lirimit të ankuses nga detyra dhe është kryer emërimi i tij. Në këtë kontekst, ankuesja pretendon se veprimet kanë qenë të qëllimshme dhe të paramenduara për ta larguar atë nga puna.

Lidhur me pretendimin për diskriminimin gjinor, ankuesja sqaron se ka qenë e vetmja femër e larguar nga puna, krahasuar me drejtorët e tjerë të institucioneve të varësisë. Ajo sqaron se gjashtë drejtorët e tjerë të institucioneve të varësisë nuk janë larguar nga puna. Nga këta drejtorë, 2 (dy) prej tyre janë femra, por ankuesja sqaron se ato kanë ndikim të fortë tek Kryetari i Bashkisë, ndërkohë që ajo nuk ka asnjë mbështetje dhe prandaj është liruar nga detyra.

Lidhur me pretendimin për diskriminim për shkaqe të tjera, ajo sqaron se është urdhëruar për të paguar një punonjës, (pjesë e anëtarësisë së grupit të rithemelimit të PD-së) i cili nuk është paraqitur në punë për të përmbushur detyrat e tij si punëmarrës që nga dita e emërimit të tij. Në vijim të procedurave, këtij personi nuk i është paguar paga për muajt (shkurt-mars-prill 2022). Nga titullari është pretenduar që të paguhet edhe pse nuk është paraqitur në punë, pasi është “njeri i tyre” she u shërben për vota. Ankuesja shprehet se ajo nuk ka pranuar të zbatojë një urdhër verbal të paligjshëm dhe ky fakt, ndër të tjera ka bërë që të lirohet nga detyra, për t’u hapur rrugë veprimeve arbitrare për të paguar një punonjës që nuk paraqitet në punë. Si rezultat punonjësi në fjalë rezulton të jetë paguar që nga momenti i largimit të saj nga puna e në vijim për muajt (maj-qershor-korrik-gusht 2022).

- Në vijim, ankuesja A.A. dërgoi shkresën nr.10.11.2022, nëpërmjet së cilës e bën me dije KMD-në se në shkresën nr. 13598/1, datë 15.09.2022, të Bashkisë Shkodër, e cila i është dërguar për dijeni edhe ankueses, rezulton një tabelë ku janë parashtruar 6 drejtoritë e varësisë si dhe emrat e drejtorëve të drejtorive përkatëse. Ajo thekson faktin se të gjithë drejtorët janë pjesë e organizatës politike PD ose të ndonjë partie aleate, duke vënë theksin se për këtë arsye këta drejtorë nuk janë liruar nga detyra.

A.A. shprehet se në datën 07.11.2022, Drejtori aktual i Drejtorise Ekonomike të Arsimit, z. E.I. ka bërë publike në faqene tij në rrjetin social Facebook, kandidaturën për Kryetar të FRPD Shkodër. Në statusin e tij vihet re angazhimi i tij politik që herët duke cituar: *“fillimet e mia të angazhimit politik lidhen me FRPD-në, më bashkojnë shumë fushata elektorale për zgjedhejt parlamentare e vendore, në mbështetje të PD-së, pjesëmarrja aktive në aktivitete të ndryshme politike. Bashkë me to kam përjetuar fitore dhe humbje, e së fundmi, sfida e përballje në opozitë prej disa vitesh...”*. Z. E.V është eksponent politik i PD-së dhe në emërimin e tij si drejtor duket qartë që është favorizuar dhe preferuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. B.S..

I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Trajtimi i padrejtë, disfavorizues dhe i pabarabartë i ankueses A.A..

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A.A. ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në Fakultetin e Shkencave Ekonomike, Dega Administrim Biznesi në vitin 2003. Referuar librezës së punës së ankueses rezulton se ajo ka filluar punë pranë Bashkisë Shkodër në datën 01.03.2005, në pozicionin e specialistes së buxhetit pranë Drejtorisë së Buxhetit. Në vitet vijuese, ankuesja ka mbajtur pozicione të ndryshme pune. Nëpërmjet Urdhërit nr. 618, datë 13.09.2016, e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, znj. A.A. është komanduar në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike e Arsimit, të Bashkisë Shkodër.

Në vijim, mbështetur në kompetencën e Kryetarit të Bashkisë, të parashikuar në nenin 64, gërma “g”, të ligjit nr. 139, datë 12.07.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil”*, nëpërmjet Vendimit nr. 88, datë 20.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, ankuesja merr emërimin definitiv në pozicionin e Drejtorit pranë Drejtorisë Ekonomike e Arsimit, të Bashkisë Shkodër. Për këtë pozicion pune, marrëdhëniet e punësimit rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës. Gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se përveç aktit të emërimit në detyrë, nuk rezulton që Bashkia Shkodër të ketë lidhur një kontratë individuale pune me znj. A.A., e cila ka vijuar detyrën e sipërcituar deri në muajin prill 2022.

Pas procesit të parë të primareve në Shqipëri mbajtur me 30 janar 2022, në datën 6 mars 2022, z. B.S., i cili përfaqëson subjektin politik Partia Demokratike e Rithemelimit, është zgjedhur kryetar i Bashkisë Shkodër dhe ka marrë zyrtarisht detyrën me 31 mars 2022.

Vetëm 3 (tre) javë pas ardhjes së tij në detyrë, ankuesja A.A. lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike e Arsimit, të Bashkisë Shkodër, nëpërmjet Urdhërit nr.228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të ri të Bashkisë. Duke iu referuar këtij urdhëri rezulton se lirimi nga detyra është i menjëhershëm dhe ankuesja nuk ka marrë asnjë njoftim paraprak nga Bashkia Shkodër për shkarkimin e saj. Njëkohësisht, rezulton se në këtë akt nuk është përmendur motivacioni i lirimit nga detyra të ankuses, e cila është në padijeni të plotë në lidhje me arsyet e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për shkarkimin e saj, në mënyrë të menjëhershme.

Gjatë hetimit administrativ të KMD-së, Bashkia Shkodër ka deklaruar se ankuesja A.A. ka shkëlur parimin e mirëbesimit, të parashikuar në nenin 153, të Kodit të Punës dhe si rrjedhim ajo është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër. Sipas informacionit të Bashkisë Shkodër, shkelja e parimit të mirëbesimit është konstatuar në shkeljet e gjetura nga grupi i auditit të Bashkisë Shkodër, gjatë kontrollit të zhvilluar pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit në vitin 2022. Referuar korrespondencës zyrtare me Bashkinë e Shkodrës, si dhe mbështetur në Raportin Final të Auditit nr. 2274/6 prot., datë 25.07.2022, rezulton se periudha e auditimit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit nga Njësia e Auditit të Bashkisë Shkodër, ka qenë nga data 01.01.2018 deri në datën 31.12.2021 dhe kohëzgjatja e auditit ka qenë nga data 23 mars deri në datën 25 prill 2022.

Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se pavarësisht konstatimeve të Njesisë së Auditit të Bashkisë Shkodër, ankuesja është liruar nga detyra në datën 27.04.2022, pra rreth 3 muaj para daljes së Raportit Përfundimtar të këtij auditit. Njëkohësisht, rezulton se pavarësisht se e liruar nga detyra, ankuesja A.A. ka dërguar në adresë të Njesisë së Auditimit pranë Bashkisë Shkodër, shkresën nr. 10892, datë 05.07.2022 *“Observacion mbi projekt-raportin e auditimit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit”* ku jepen sqarimet përkatëse mbi gjetjet e grupit të auditit në Projekt Raportin e Auditit të dorëzuar në datën 23.06.2022. Në këtë kontekst, rezulton se largimi nga detyra i znj. A.A. mban datë më të herëshme, edhe se dalja e Raportit Paraprak të Auditit. Një gjë e tillë nënkupton që shkeljet e gjetura në këtë raport nuk kanë qenë të konstatuara dhe të vërtetuara në momentin e shkarkimit të saj nga detyra.

Duke iu referuar pretendimit të Bashkisë Shkodër, lidhur me shkeljen e parimit të mirëbesimit nga ana znj. A.A., KMD ka analizuar përmbajtjen e nenit 153 të Kodit të Punës, ku parashikohet shkaqet e arsyeshme për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së punës. Pikat 1 dhe 2 të nenit 153 të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht se:

1. *“Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara.*

2. *Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.*
3. *Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.”*

Për sa më sipër, Komisioneri, gjykon se në interpretim të dispozitës në fjalë, dy janë kushtet kryesore dhe kumulative, që duhen plotësuar në mënyrë që zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës të jetë e rregullt proceduralisht dhe e justifikuar:

Kushti i parë është *kushti subjektiv* që lidhet me qëndrimin subjektiv, shkeljen e raportit të mirëbesimit ndaj punëdhënësit, por që në çdo rast duhet që rrethana të jetë abuzive dhe kushti i dytë, *kushti objektiv*, ku punëmarrësi duhet të ketë kryer një shkelje me faj të rëndë ose të lehtë, në mënyrë të përsëritur dhe gjithmonë pas një lajmërimi përkatës, si dhe të ketë një lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së kryer dhe zgjidhjes së menjëherëshme të kontratës dhe shkelja të ketë cënuar raportin e mirëbesimit midis palëve.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se Bashkia Shkodër, në asnjë rast nuk ka evidentuar shkeljet me faj të rëndë ose të lehtë, në mënyrë të përsëritur që znj. A.A. supozohet që ka kryer, si dhe asnjëherë nuk e ka njoftuar me shkrim paraprakisht ankuesen mbi shkeljet e konstatuara në punën e saj. Në momentin e shkarkimit të saj nga detyra që mban datën 27.04.2022, Njësia e Auditit të Bashkisë Shkodër ende nuk kishte nxjerrë Projekt-Raportin e Auditit, pasi afati i auditimit pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ishte deri në datën 25 prill 2022. Në këto kushte, Bashkia Shkodër nuk kishte asnjë fakt dhe provë për të justifikuar “shkaqet e justifikueshme” të parashikuara në nenin 153 të Kodit të Punës, fakt që reflektohet edhe në mungesën e motivacionit në urdhërin e lirimit nga detyra.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ. Gjykata Kushtetuese⁴, në Vendimin nr. 69, datë 16.10.2000, ka mbajtur qëndrimin se: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”.*

⁴ “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se shkarkimi nga detyra i ankueses është bërë pa shkaqe ligjore të justifikuara. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës/marrëdhënies së punës që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Shkodër nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës. Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara.

Përveç sa më sipër, Komisioneri konstatoi gjithashtu se në të njëjtën datë, kur ankuesja është liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr.228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë, në këtë pozicion pune është emëruar z. E.I. nëpërmjet Urdhërit nr.229, datë 27.04.2022, të Kryetarit të ri të Bashkisë. Një fakt i tillë përforcon idenë, se ankuesja është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejte dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Shkodër, për të emëruar dikë tjetër në pozicionin e punës Drejtor pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

B. Shkaqet e diskriminimit të pretenduar.

B/1. Shkaku i diskriminimit të pretenduar “bindja politike”

Znj. A.A. pretendon diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”, nga ana e Bashkisë Shkodër. Ankuesja ka pretenduar se nuk ka bindje të mirëfillta politike dhe nuk është e atashuar pranë ndonje partie politike, fakt të cilin e ka konsideruar si shkakun kryesor të lirimit nga detyra.

“Bindja politike” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në të drejtën ndërkombëtare, shpesh përdoret termi *mendimi politik dhe tjetër* (ang. *Political and other opinion*), dhe me këtë përfshihet dhe përkatësia politike. Përkatësia politike duhet të interpretohet në mënyrë që të mbulojë lidhjen me ndonjë opSION të caktuar politik ose parti politike, me të cilën do t’i përfshijë dhe rastet kur bëhet fjalë për përkatësinë formale (anëtarësinë), por dhe llojet e tjera të lidhjeve, përmes të cilave mund të tregohet lidhje me ndonjë parti ose opSION tjetër politik. Me qëllim interpretimi sa më gjithëpërfshirës të këtij shkaku, i cili duhet të jetë në pajtueshmëri me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, rekomandohet që në këtë shkak të përkatësisë politike, të përfshihen rastet e anëtarësisë formale ose joformale dhe llojet e tjera të lidhjes me partitë politike.

Këtë qëndrim mban dhe Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, e cila, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: “...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situata faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin, ashtu siç u arsyetua më lart në këtë vendim, nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri gjykon se në rastin konkret bindja politike konsiderohet si shkak i mbrojtur.

B/2. Shkak i diskriminimit të pretenduar “gjendja arsimore”

Znj. A.A. pretendon diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore”, nga ana e Bashkisë Shkodër.

“Gjendja arsimore” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Komisioneri gjykon se gjendja arsimore konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si e tilla në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe ankuesja ka depozituar në cilësi prove dokumentacionin përkatës, ku evidenton arsimin e saj si ekonomiste dhe kualifikimet e përfituara.

B/3. Shkak i diskriminimit të pretenduar “gjinia”

Znj. A.A. pretendon diskriminim për shkak të “gjinisë”, nga ana e Bashkisë Shkodër

“Gjinia” është një prej shkaqeve, për të cilat, ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Komisioneri gjykon se gjinia konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si e tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, si dhe argumentimi i ankueses ka krijuar bindjen e KMD-së se gjinia konsiderohet shkak i mbrojtur.

B/4 Shkak i diskriminimit të pretenduar për “çdo shkak tjetër” - “moszbatimi i urdhërit verbal të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, për pagesën e ditëve të punës së një punonjësi të PD-së, që nuk paraqitej në punë”.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja A.A. shtoi si shkak diskriminimi faktin se ajo është liruar nga detyra, pasi nuk i ka paguar ditët e punës disa punonjësve, që kanë anëtarësi në PD dhe nuk paraqiteshin në detyrë, edhe pse i është dhënë urdhër verbal nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për t'i paguar ata. Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesja ka dërguar zyrtarisht informacion, ku sqaron se urdhëri verbal i Kryetarit të Bashkisë ka qenë për të paguar ditët e punës së një punonjësi, z. O. V., me detyrë “*technik për mirëmbajtje ndërtesash*”, i emëruar në detyrë në datën 07.02.2022⁵, i cili nuk është paraqitur në punë.

Neni 1, i ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “*për çdo shkak tjetër*”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “*çdo shkak tjetër*” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së, së ndryshuar nëpërmjet termit “*çdo shkak tjetër*” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “*shkakun*” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, për të cilin LMD, i ndryshuar ofron mbrojtje. Për sa më sipër, shkak i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit dhe si i tillë, para pranimit për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesit, duhet vërtetuar *së pari* ligjshmëria e tij, si dhe së dyti duhet mbështetur provueshmëria e tij.

Për sa më sipër, shkak i diskriminimit lidhet përgjithësisht me një karakteristikë apo veçori të ankuesit, si pasojë e se cilit ai trajtohet në mënyrë të disfavorshme, të padrejtë dhe të pabarabartë. Në praktikën e vendimeve të KMD-së, nën termin “*çdo shkak tjetër*” është konsideruar edhe rasti kur pretendohet diskriminim për shkak të një ankimi apo moszbatimi i urdhërave të eprorëve.

Ankuesja ka depozituar në cilësi prove, vetëm listëpagesat për muajt shkurt, mars dhe prill 2022, ku emri i z. O.V. nuk figuron në to. Ndërkohë që, në listëprezencat vijuese emri i tij, figuron në to. Znj. A.A. nuk ka depozituar në cilësi prove asnjë provë tjetër që involvon Kryetarin e Bashkisë Shkodër në dhënien e një urdhëri të paligjshëm, për të paguar personin e sipërcituar, si dhe asnjë të dhënë mbi përkatësinë politike të z. O.V., i cili rezulton të jetë punësuar nga ish-

⁵ Referuar Urdhërit nr. 92, datë 07.02.2022 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër;

Kryetarja e Bashkisë Shkodër. Mungesat e sipërcituara, z. O.V. ka filluar t'i kryejë që gjatë periudhës kohore, kur ish-Kryetarja e Bashkisë Shkodër ka qenë në detyrë, ndërkohë që, Komisioneri ka konstatuar gjithashtu që ankuesja A.A., në cilësinë e titullares së institucionit të varësisë nuk ka marrë asnjë masë disiplinore ndaj këtij personi që nuk paraqitej rregullisht në punë. KMD çmon se pikërisht, janë këto të dhëna, fakte dhe prova, të cilat do të kishin ndikuar në provueshmërinë e shkakut të diskrimimit të pretenduar nga ana e znj. A.A..

Nga tërësia e provave të depozituara nga ankuesja, për këtë shkak të pretenduar, Komisioneri gjykon se provueshmëria e tij nuk faktohet.

Në këto kushte, KMD gjykon se ky shkak nuk mund të konsiderohet si shkak i mundshëm diskriminimi lidhur me çështjen objekt shqyrtimi.

C.Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

C/1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – bindja politike.

Në ankesën nr.86, datë 31.05.2022, e znj. A.A. pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” nga ana e Bashkisë Shkodër.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.⁶

Gjykata Kushtetuese⁷, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit*

⁶ Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.

Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cënuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis shtetit dhe individit, e cila rregullohet nga Kodi i Punës.

Parimi i mosdiskriminimit përshkon në frymë dhe në nene këtë akt rregullator, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁸.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të

⁷ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

⁸Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Në Nenin 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) parashikohet shprehimisht se: *“Të gjitha qeniet njerëzore janë të lindur të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta”*.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, është jo vetëm pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njihet dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshtruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollin 12-të të Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, konkretisht, çështjes *Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i cili ishte ankuar se shkakimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja është shprehur se: *“...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkakimin e punonjësit për shkak të anëtarësimit të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm”*. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës (KEDNJ)⁹.

⁹*“Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i ketyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”¹⁰, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.

Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës¹¹ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Në kuptim të kësaj Konvente termi “diskriminim” përfshin: a) çdo dallim, përjashtim ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, seksin, fenë, opinionin politik, prejardhjen kombëtare ose origjinën sociale, që ka për efekt të prishë ose të shtrembërojë barazinë e mundësive ose të trajtimit në fushën e punësimit ose të profesionit, b) çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose profesionit, që mund të specifikohet nga një anëtar i interesuar, pasi të ketë konsultuar organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punonjësve, si dhe organizma të tjerë të përshtatshëm.

Njëkohësisht, eliminimi i diskriminimit u ripohua si një kriter i pandarë i çdo politike të ILO-s¹² që prej adoptimit në vitin 1998 të “Deklaratës së ILO-s mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”. Kjo Deklaratë përcakton se të gjitha të drejtat themelore të njeriut duke përfshirë edhe eliminimin e diskriminimit përsa i përket punësimit dhe profesionit janë shumë të domosdoshme për mandatin e ILO-s. Në Deklaratë citohet se anëtarësia në Organizatë nga një shtet krijon në vetvete një detyrim për të promovuar këto të drejta edhe sikur shteti të mos këtë ratifikuar Konventat Themelore që parashatrojnë këto kritere.

*Karta Sociale Europiane*¹³ në nenin 1, pika 2, parashikon: *“Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen...2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...”*

dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹⁰ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

¹¹ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

¹² International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

¹³ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002.

Ky parashikim është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim¹⁴.

Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura: “Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”.

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë.

Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme¹⁵.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është *diskriminimi i drejtpërdrejtë*, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si *një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji*.

Bazuar në nenin 9/1 të Kodit të Punës, që përbën legjislacionin mbi bazën e të cilit, rregullohet marrëdhënia e punës në rastin e ankuesit, ndalohej çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Mbështetur në nenin 9/2 të Kodit të Punës, diskriminimi përkufizohet si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo parapëlqim që bazohet në një nga shkaqet e mbrojtura ndër të tjera edhe

¹⁴ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

¹⁵ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

në bindjet politike, që ka si qëllim apo pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion në të njëjtën mënyrë me të tjerët”.

Ndërsa pika 5, shkronja c) e Kodit parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”*

Në bazë të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁶ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 9/10 të Kodit të Punës, barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm.

Bazuar në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, parashikohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

Bazuar në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik*

¹⁶ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, të ndryshuar, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues.

Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse Bashkia Shkodër, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese, nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁷

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në këtë kontekst, KMD vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit të ankueses nga ana e Bashkisë Shkodër dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Shkodër duhet të përmbushte njërin nga dy kushtet e përmendura më sipër.

Ankuesja A.A. ka mbajtur pozicionin e drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, pranë Bashkisë Shkodër për rreth 6 vjet. Znj. A.A. ka deklaruar se nuk është e anëtarësuar në asnjë parti politike dhe nuk merr pjesë në aktivitetet politike të asnjë subjekti politik. Në këtë kontekst, ajo pretendon se është liruar nga detyra për shkak të bindjes së saj politike, pasi nuk ka të tilla dhe për këtë arsye nuk ka patur mbështetje nga Kryetari aktual i Bashkisë Shkodër. Në pikën 67,

¹⁷https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law2018_en.pdf, fq.232.

të vendimit nr. 31/2021, të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, citohet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situata faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin, ashtu siç u arsyetua më lart në këtë vendim, nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.*

Pas procesit të parë të primareve në Shqipëri mbajtur me 30 janar 2022, në datën 6 mars 2022, z. B.S., i cili përfaqëson subjektin politik Partia Demokratike e Rithemelimit, është zgjedhur kryetar i Bashkisë Shkodër dhe ka marrë zyrtarisht detyrën me 31 mars 2022.

Vetëm 3 (tre) javë pas ardhjes së tij në detyrë, ankuesja A.A. lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike e Arsimit, të Bashkisë Shkodër, nëpërmjet Urdhërit nr.228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të ri të Bashkisë. Duke iu referuar këtij urdhëri rezulton se lirimi nga detyra është i menjëhershëm dhe ankuesja nuk ka marrë asnjë njoftim paraprak nga Bashkia Shkodër për shkarkimin e saj. Njëkohësisht, rezulton se në këtë akt nuk është përmendur motivacioni i lirimit nga detyra të ankueses, e cila është në padijeni të plotë në lidhje me arsyet e Kryetarit të Bashkisë Shkodër për shkarkimin e saj, në mënyrë të menjëhershme.

Gjatë hetimit administrativ të KMD-së, Bashkia Shkodër ka deklaruar se ankuesja A.A. ka shkelur parimin e mirëbesimit, të parashikuar në nenin 153, të Kodit të Punës dhe si rrjedhim ajo është liruar nga detyra në mënyrë të menjëherëshme nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër. Sipas informacionit të Bashkisë Shkodër, shkelja e parimit të mirëbesimit është konstatuar në shkeljet e gjetura nga grupi i auditit të Bashkisë Shkodër, gjatë kontrollit të zhvilluar pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit në vitin 2022. Referuar korrespondencës zyrtare me Bashkinë e Shkodrës, si dhe mbështetur në Raportin Final të Auditit nr. 2274/6 prot., datë 25.07.2022, rezulton se periudha e auditimit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit nga Njësia e Auditit të Bashkisë Shkodër, ka qenë nga data 01.01.2018 deri në datën 31.12.2021 dhe kohëzgjatja e auditit ka qenë nga data 23 mars deri në datën 25 prill 2022.

Për sa më sipër, Komisioneri konstatoi se pavarësisht konstatimeve të Njesisë së Auditit të Bashkisë Shkodër, ankuesja është liruar nga detyra në datën 27.04.2022, pra rreth 3 muaj para daljes së Raportit Përfundimtar të këtij auditit. Njëkohësisht, rezulton se pavarësisht se e liruar nga detyra, ankuesja A.A. ka dërguar në adresë të Njesisë së Auditimit pranë Bashkisë Shkodër, shkresën nr. 10892, datë 05.07.2022 *“Observacion mbi projekt-raportin e auditimit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit”* ku jepen sqarimet përkatëse mbi gjetjet e grupit të auditit në Projekt Raportin e Auditit të dorëzuar në datën 23.06.2022. Në këtë kontekst, rezulton se largimi nga detyra i znj. A.A. mban datë më të herëshme, edhe se dalja e Raportit Paraprak të Auditit. Një

gjë e tillë nënkupton që shkeljet e gjetura në këtë raport nuk kanë qenë të konstatuara dhe të vërtetuara në momentin e shkarkimit të saj nga detyra.

Komisioneri çmoi se Bashkia Shkodër, në referencë të nenit 153, pika 1 e 2, të Kodit të Punës, në asnjë rast nuk ka evidentuar shkeljet me faj të rëndë ose të lehtë, në mënyrë të përsëritur që znj. A.A. supozohet që ka kryer, si dhe asnjëherë nuk e ka njoftuar me shkrim paraprakisht ankuesen mbi shkeljet e konstatuara në punën e saj. Në momentin e shkarkimit të saj nga detyra që mban datën 27.04.2022, Njësia e Auditit të Bashkisë Shkodër ende nuk kishte nxjerrë Projekt-Raportin e Auditit, pasi afati i auditimit pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit ishte deri në datën 25 prill 2022. Në këto kushte, Bashkia Shkodër nuk kishte asnjë fakt dhe provë për të justifikuar “shkaqet e justifikueshme” të parashikuara në nenin 153 të Kodit të Punës, fakt që reflektohet edhe në mungesën e motivacionit në urdhërin e lirimit nga detyra.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ. Gjykata Kushtetuese¹⁸, në Vendimin nr. 69, datë 16.10.2000, ka mbajtur qëndrimin se: *“Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”*.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se shkarkimi nga detyra i ankuses është bërë pa shkaqe ligjore, të justifikuara. Në referencë të parashikimeve ligjore që normojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë, është më se e qartë se ligji ngarkon punëdhënësin me barrën e provës për të vërtetuar shkaqet e deklaruara të zgjidhjes së kontratës së punës/marrëdhënies së punës që rregullohet nga dispozitat e Kodit të Punës. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Shkodër nuk arriti të provojë motivacionin e zgjidhjes së kontratës së punës. Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyet e deklaruara nga punëdhënësi për largimin nga puna, rezultuan të paprovuara.

Përveç sa më sipër, Komisioneri konstatoi gjithashtu se në të njëjtën datë, kur ankuesja është liruar nga detyra nëpërmjet Urdhërit nr.228, datë 27.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë, në këtë pozicion pune është emëruar z. E.I. nëpërmjet Urdhërit nr.229, datë 27.04.2022, të Kryetarit të ri të Bashkisë. Një fakt i tillë përforcon idenë, se ankuesja është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Shkodër, për të emëruar dikë tjetër në pozicionin e punës Drejtor pranë Drejtorisë Ekonomike të Arsimit. Referuar provave të depozituara nga ankuesja, si dhe në bazë të verifikimeve të kryera nga KMD, rezulton se z. E.I. është anëtar i Partisë Demokratike të Rithemelimit, si dhe ka qenë kandidat në primaret e zhvilluara në këtë

¹⁸ “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”*.

parti së bashku me kryetarin aktual të Bashkisë Shkodër¹⁹. Në vijim, rezulton se z. E.I. është tërhequr nga gara në primaret e Partisë Demokratike, duke i dhënë mbështetjen dhe votën e tij, kandidatit B.S., aktualisht Kryetar i Bashkisë Shkodër. Ankuesja është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit, pa respektuar asnjë procedurë të parashikuar në dispozitat e Kodit të Punës e pa asnjë shkak të arsyeshëm dhe në vendin e saj është emëruar z. E.I. që është anëtar, aktivist i subjektit politik Partia Demokratike e Rithemelimit, ku aderom Kryetari i Bashkisë Shkodër, si dhe është mbështetës i këtij të fundit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se gjatë hetimit administrativ, nga ana e Bashkisë Shkodër nuk u arrit të provohej që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar, që është bindja politike dhe trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm.

Për sa më sipër, KMD gjykon se Bashkia Shkodër e ka diskriminuar ankuesen A.A. për shkak të bindjes politike.

Mbështetur në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuses konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së saj të punës. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuses, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e rikthyer ankuesen në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

¹⁹ <https://www.faxweb.al/4-kandidatet-e-mbetur-ne-gare-jane-me-te-miret-e-qyetit-ivziku-hoqi-dore-nga-gara-per-kreun-e-pd-se-ne-shkoder-ja-arsyeja/>
<https://opinion.al/te-rinjte-ne-politike-fasade-apo-modele-te-gabuara-flasin-aktivistet/>
<https://www.youtube.com/watch?v=5z3sCwxLZ34> - U terhoq nga gara per kreun e PD dega Shkoder, Ergys Ivziku
<https://www.youtube.com/watch?v=ms15dNa09CE> - Takimi i Berishës në Shkodër/ Ergys Ivziku: Demokratët shkodranë janë të karikuar – Fax news Albania

Në nenin 9, pika 9, të Kodit të Punës sanksionohet: *“9. Në rastin kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.”* Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi, është ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar. Në nenin 38 të këtij ligji, që rregullon procedurat e gjykimit të padisë për diskriminim përpara gjykatës, ligji përcakton: *“Dëshmipërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”*.

Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Kodi i Punës, në mënyrë të shprehur referon në dispozitat e ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj, përmes parashikimit në nenin 38 të tij, se dëshmipërblimi për diskriminimin përfshin ndër të tjera edhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, njeh të drejtën e personit që konstatohet se është larguar për shkaqe diskriminuese, që të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit, pasi me kushtin që të paguajë dëshmipërblimin për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë, sipas parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës, ai mund të largojë çdo punonjës bazuar në një shkak të mbrojtur nga legjislacioni.

B/2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – gjendja arsimore.

Në ankesën nr.86, datë 31.05.2022, e znj. A.A. pretendohet diskriminim për shkak të *“gjendjes arsimore”* nga ana e Bashkisë Shkodër.

Mbështetur në korrespondencën zyrtare me Bashkinë Shkodër dhe dokumentacionit të depozituar në cilësi prove nga ky institucion rezulton se se nuk ka përsëkrime të mirëfillta pune për drejtorët e institucioneve të varësisë. Njëkohësisht, në Rregulloren nr. 96, datë 20.03.2017, *“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Shkodër”* nuk rezulton të ketë përcaktime specifike të detyrave dhe funksioneve për secilin prej institucioneve të varësisë së Bashkisë Shkodër.

Referuar standardit të provës të parashikuar nga neni 82/2 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, si dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pala ankuese nuk arriti të krijojë një prezumim të diskriminimit, pra

një diskriminim *prima facie*. Pavarësisht, konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj ankueses nga ana e Bashkisë Shkodër dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit – *gjendja arsimore*, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesja është si rezultat i gjendjes arsimore dhe se në mungesë të saj, ankuesja do të ishte trajtuar ndryshe.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Bashkia Shkodër nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm, të cilit i është nënshtruar ankuesi nuk përbën diskriminim.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se lirimi i saj nga detyra nuk ka lidhje me gjendjen e saj arsimore, që kupton se marrëdhënia e saj e punës nuk është zgjidhur nga Bashkia Shkodër, pasi arsimi i saj është ekonomiste. Njëkohësisht, KMD gjykon se gjendja e saj arsimore dhe eksperiencia e saj në punë kanë qenë rrethanë favorizuese për të dhe Bashkia Shkodër nuk ka patur asnjë shkak të largojë një drejtuese të kualifikuar për ta zëvendësuar atë me dikë më pak të kualifikuar.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesja A.A. nuk është diskriminuar për shkak të gjendjes së saj arsimore nga ana e Bashkisë Shkodër.

B/3.Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë me shkakun e mbrojtur – gjinia.

Në ankesën nr.86, datë 31.05.2022, e znj. A.A. pretendohet diskriminim për shkak të “*gjinisë*” nga ana e Bashkisë Shkodër. Ankuesja pretendon se shkakun i lirim të saj nga detyra është gjinia e saj, pasi është femër. Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KMD-së, ankuesja ka theksuar faktin se është e vetmja drejtore femër e larguar nga institucionet e varësisë së Bashkisë Shkodër.

Referuar informacionit të dërguar nga Bashkia Shkodër mbi këtë çështje rezulton se përveç znj. A.A., aktualisht ushtrojnë detyrën e drejtuesit në institucionet e varësisë të Bashkisë Shkodër edhe dy femra të tjera, përkatësisht drejtorja e Teatrit Migjeni, e cila është emëruar në datën 04.06.2008 dhe drejtorja e Drejtorisë së Çerdheve dhe Kopështeve, e cila është emëruar në datën 07.04.2004. Të dyja këto titullare rezultojnë të jenë emëruar në detyrë para ardhjes në detyrë të Kryetarit aktual të Bashkisë Shkodër, sikurse edhe ankuesja.

Lidhur me faktin e sipërcituar, znj. A.A. ka sqaruar që të dy drejtueset femra që janë ende në detyrë, nuk janë liruar nga detyra, pasi kanë ndikim tek Kryetari i Bashkisë Shkodër, ndërkohë që nuk ka cilësuar dhe sqaruar natyrën e ndikimit, që ato kanë patur tek titullari, i cili nuk i ka liruar nga detyra sikurse ankuesen për shkakun e pretenduar. Për sa më sipër, znj. A.A. nuk ka depozituar fakte dhe prova që të vërtetojë pretendimin e saj.

Referuar standardit të provës të parashikuar nga neni 82/2 i Kodit të Procedurave Administrative dhe neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, si dhe bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pala ankuese nuk arriti të krijojë një prezumim të diskriminimit, pra një diskriminim *prima facie*. Pavarësisht, konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm ndaj ankuses nga ana e Bashkisë Shkodër dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit – *gjinia*, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesja është si rezultat i gjendjes arsimore dhe se në mungesë të saj, ankuesja do të ishte trajtuar ndryshe.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, Bashkia Shkodër nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe më pak i favorshëm, të cilit i është nënshtruar ankuesja nuk përbën diskriminim.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se lirimi i saj nga detyra nuk ka lidhje me gjininë e saj, që kupton se marrëdhënia e saj e punës nuk është zgjidhur nga Bashkia Shkodër, pasi arsimi i saj është femër. Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesja A.A. nuk është diskriminuar për shkak të gjinisë nga ana e Bashkisë Shkodër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, pika 2, nenin 7, pika 3, neni 12, pika 1, gërma “c”, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenit 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike të znj. A.A., nga ana e Bashkisë Shkodër.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të gjendjes arsimore dhe gjinisë të znj. A.A., nga ana e Bashkisë Shkodër.
3. Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, Bashkia Shkodër të marrë masa për të rikthyer ankuesen A.A. në vendin e mëparshëm të punës, ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Bashkia Shkodër, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha – Punësim

Shkak – bindja politike, gjinia, gjendja arsimore dhe cdo shkak tjetër

Lloji i vendimit - Diskriminim